



REAGIM PUBLIK I OBSERVATORIT

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve është njohur kohët e fundit nga mediat me ngjarje tronditëse që kanë lidhje me dukurinë e pedofilisë, një sërë rastesh ku fëmijët janë abuzuar apo kanë qenë në risk abuzimi. Nëpërmjet përfaqësuesve të zyrës së Observatorit në 12 qarqet e vendit, është bërë i mundur verifikimi dhe ndjekja e këtyrë rasteve të bëra publike, me qëllim koordinimin dhe mobilizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve që në nivel lokal. Krimet seksuale janë ndër shkeljet më të rënda për integritetin fizik, moral dhe emocional të fëmijëve.

Nëpërmjet këtij *reagimi publik*, Observatori shpreh shqetësimin e tij në mbrojtje të fëmijëve të abuzuar, duke ju kërkuar Institucioneve përgjegjëse lokale deri në nivel qendror që të jenë mbrojtës dhe garantues të të drejtave themelore për zhvillim të fëmijëve në vendin tonë. Kërkojmë që i gjithë sistemi mbrojtës i të drejtave të fëmijëve dhe të gjitha segmentet përgjegjëse, të punojnë për të ofruar zgjidhje jo vetëm në rastet kur ballafaqohen me këto raste sic kanë ndodhur këto ditë, por të garantojnë masat parandaluese për sigurinë e çdo fëmijë, kudo që ai/ ajo jeton.

Prindërit shqiptarë duan t'i mbrojnë fëmijët e tyre, por:

- A janë ata të informuar mjaftueshëm për t'i parandaluar këto trauma? -A e dinë ata se në më të shumtën e rasteve fëmija viktimë dhe abuzuesi nuk janë krejt të panjohur për njëri-tjetrin? Ai mund të jetë një pjesëtar i familjes, mund të jetë një mësues, komshiu etj. , - si në rastin e të miturit nga Erseka, si në rastin e të miturës nga Fieri, apo në rastin e djemve nga Tirana vs Hazer Duraku...etj

-A e dinë ata se në disa raste pedofilët janë shumë agresivë dhe përdorin dhunë fizike, psikologjike duke shkaktuar edhe vrasjen e viktimës apo çuar në vetëvrasje? Rasti i vajzës dibrane, 17 vjeçare i bërë publik është një shembull i kësaj dhune. Ajo zgjodhi mënyrën e gabuar për të “gjetur” lirinë në kushtet e mungesës së shpresës, së informacionit dhe mbështetjes. Ajo shpresoi një tjetër botë ku do të jetonte në paqe, larg shantazhit psikologjik të një 50 vjeçari i cili kërkonte me çdo kusht të vazhdonte abuzimin me të. Faktet e deritanishme hedhin dritë mbi tmerrin e përjetuar prej saj dhe shtrëngimin për të bërë disa zgjedhje të detyruara.

-A e dinë ata se në disa raste pedofilët përdorin besimin e fëmijëve, autoritetin ndaj tyre, argumentin që po bëjnë një lojë interesante?

-A e dinë ata se në rastet kur nuk përdoret dhuna, pedofilët u kërkojnë fëmijëve që të ruajnë sekretin e tyre? Si në rastin e vajzës 11 vjeçare në Himarë e cila është ngacmuar seksualisht nga një i moshuar. Edhe pse në kushtet e dëshmisë së vajzës, të kamerave të supermarketit ku ka ndodhur ngacmimi dhe të nje precedenti të mëparshëm të ngjashëm, i moshuari ndodhet në arrest shtëpie në mungesë të provave.

- A e dinë **përfaqësuesit** e sistemit të drejtësisë se duhet guxim për të raportuar abuzimin?

- Fëmijët të përfshirë nga ndjenja turp, fajit, mosbesimit apo të frikës nga abuzuesi shpesh ngurojnë t'a denoncojnë atë. Dhe nëse kanë gjetur forcën për t'a rrëfyer tek familjarët, këta të fundit mund të hezitojnë nisur nga mosbesimi në sistemin e drejtësisë apo pasojat e shumëfishta ndër to dhe stigmatizimin social. – Këtë forcë dhe mbështetje e gjeti dhe e mitura 15 vjeçare nga Tirana, por fatkeqesisht sot ne seancën gjyqësore ka denoncuar një sulm pothuajse fatal ndaj saj të ndodhur menjëherë pas denoncimit.

Duke synuar që fëmijët të cilët gjejnë kurajon të raportojnë abuzimin, të ndihen të sigurt, të mbështetur dhe më të fortë nga përballja me sistemin e drejtësisë, Observatori kërkon respektimin me rigorozitet të instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare përfshirë dhe Konventën e Lanzarotës/ Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Shpresojmë që vajza 17 vjeçare nga Dibra, shumë shpejt do të gjejë lirinë e dëshiruar duke hedhur dritë mbi të vërtetën, cilado qoftë ajo, shpresojmë që 11 vjeçarja në Himarë t'i rikthehet edukimit dhe lojës si të gjithë moshatarët e saj duke mos pasur frikë nga një takim i “rastësishëm” me të moshuarin, ndërsa për 15 vjeçaren nga Tirana shpresojmë se të vërtetat e thëna dhe të pathëna do e ndihmojnë të bëhet një grua të fortë, një nënë dhe një bashkëshorte krenare për vendimet e saj.

22 Janar 2016, Observatori për të Drejtat e fëmijëve